

Faktorët e riskut që zbatohen nga SIGAL UNIQA



Në përlogaritjen e primit të sigurimit shoqëria e sigurimit SIGAL UNIQA Group Austria zbaton këto faktorë kryesorë risku: A

1. Historiku i dëmeve, përfshirë edhe rastet kur shkaktari i aksidentit nuk është i shënuar në policën e sigurimit.
2. Fuqia motorike.
3. Mosha e të siguruarit.
4. Eksperienca në drejtimin e mjetit motorik.
5. Përdorimi i mjetit: subjekt, individ.
6. Qarku i regjistrimit të mjetit.
7. Vjetërsia e mjetit.

Formula për përlogaritjen e primi të sigurimit për kategori të paraqitet si vijon:

$$P_{S,K} = \frac{PR,K}{(1-(\alpha+\beta+\gamma))}$$

ku:

- PS,K përfaqëson primin e sigurimit për kategori;
- PR,K përfaqëson primin e rrezikut për kategori;
- α, β, γ përfaqësojnë shpenzimet e marrjes në sigurim, shpenzimet administrative dhe marzhin e pritshtëm të fitimit të shoqërisë.

Primi i sigurimit, bazuar në faktorët e riskut, përftohet si vijon:

$$PS,FR = PS,K \cdot hD \cdot gj \cdot mi \cdot ne \cdot Ps,i \cdot Qp \cdot Vm \cdot Ftj$$

ku:

- PS,FR përfaqëson primin e sigurimit bazuar në faktorët e riskut;
- hD përfaqëson faktorin e riskut *Historiku i dëmeve për të siguruarin, përfshirë edhe rastet kur shkaktari i aksidentit nuk është i shënuar në policën e sigurimit;*
- gj përfaqëson faktorin e riskut *fuqia motorike;*
- mi përfaqëson faktorin e riskut *mosha e të siguruarit;*
- ne përfaqëson faktorin e riskut *eksperienca në drejtim të mjetit motorik;*
- Ps,i , përfaqëson faktorin e riskut *Përdorimi i mjetit: subjekt, individ;*
- Qp , përfaqëson faktorin e riskut *Qarkun e regjistrimit të mjetit;*
- Vm , përfaqëson faktorin e riskut *Vjetërsia e mjetit.*
- Ftj , përfaqëson faktorë të tjerë risku, përveç këtyre të parashikuara në këtë rregullore, të zbatuar nga shoqëria e sigurimit.

Më poshtë paraqiten faktorët e riskut që kompania SIGAL Uniqa Group Austria do të aplikojë nga data 1 Janar 2025, sipas përcaktimit në rregullore për hyrjen në fuqi të tarifave me faktorë risku.

1. Historiku i dëmeve (h_D):

Duke qenë se viti 2025 është viti 0, ky faktor risku nuk është marrë në konsideratë. Si rrjedhojë koeficienti është përcaktuar 1.

Klasa	Koeficienti	
I	Asnjë dëm të raportuar gjatë vitit	1

II	Një dëm të raportuar gjatë vitit	1
III	Dy ose më shumë dëme të raportuara gjatë tre viteve të fundit	1

2. Fuqia motorike (g_j):

Klasa		Koeficienti
I	deri në 1300 cm ³	0.904
II	nga 1301 cm ³ deri në 1600 cm ³	0.95
III	nga 1601 cm ³ deri në 1800 cm ³	0.994
IV	nga 1801 cm ³ deri në 2000 cm ³	1.05
V	nga 2001 cm ³ deri në 2500 cm ³	1.1
VI	nga 2501 cm ³ deri në 3000 cm ³	1.15
VII	mbi 3000 cm ³	1.197

Shënim: Automjetet elektrike përfshihen në klasën I: deri në 1300 cm³.

3. Mosha e të siguruarit (m_i):

Klasa		Koeficienti
I	18 deri në 21 vjec	1.15
II	Të tjerë	1

4. Eksperienca në drejtim të mjetit motorik (n_e):

Duke qenë se nuk kemi informacion në bazën e të dhënave lidhur me këtë faktor risku, koeficienti u vendos 1.

Klasa		Koeficienti
I	Deri në dy vite	1
II	Mbi dy vite	1

5. Përdorimi i mjetit ($P_{s,i}$):

Klasa		Koeficienti
I	Individ	1
II	Subjekt	1.2

6. Qarku i regjistrimit të mjetit (Q_p):

Klasa		Koeficienti
I	Berat, Dibër, Kukës	0.97
II	Të tjera	1

7. Vjetërsia e mjetit (V_m):

Klasa		Koeficienti
I	deri në 5 vjet	0.98
II	nga 6 deri në 10 vjet	0.995
III	nga 11 deri në 15 vjet	1.02
IV	mbi 15 vjet	1.05